



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit

Rruga Abdi Toptani, nr.2 Tiranë

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr.13/5 Prot.

Tiranë, më 30.09.2019

V E N D I M
Nr. 115, Datë 30.09.2019

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT ELBASAN
“MBI VEPRIMTARINË EKONOMIKO FINANCIARE, MONITORIMI DHE MBROJTJA
E MJEDISIT”, për periudhën nga data 01.9.2016 deri më datën 31.12.2018.**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Elbasan, rezultoi që në periudhën e auditimit, pavarësisht përpjekjeve të stafit të saj në realizimin e detyrave të caktuara me ligj për përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e Qarkut të Elbasanit, një evidentuarmangësi dhe të meta në zbatimin e akteve ligjore, kryesisht në fushën financiare dhe monitorimin e mbrojtjes së mjedisit, mungesë bashkëpunimin me institucionet e tjera përgjegjëse në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të Qarkut Elbasan, që ka sjellë mangësi në fushën e licencimit dhe pëlqimeve mjedisore nga institucioni që kemi audituar, etj.

Auditimi ka filluar sipas Programit të Auditimit nr.13/1/1 datë 7.01.2018, nga data 24.01.2016 deri në datën 15.3.2019 pas njoftimit të DRM Elbasan me shkresën e Njoftimit për fillimin e auditimit me nr.13 datë 7.01.2019. Me shkresë nr. 13/2 datë 26.4.2019 është nisur Projekt Raporti në subjekti DRM Durrës dhe me shkresë nr. 13/3 datë 10.05.2019 kanë ardhur observacionet e subjektit. Në datën 28.06.2019 është shprehur Drejtoria e Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë. Në datën 01.10.2019 është shprehur Drejtori i Metodologjisë dhe Zhvillimit të KLSH.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të

mësipërm, Drejtori i Drejtorisë Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për veprimtarinë ekonomike-financiare, monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit” të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Elbasan, sipas Programit të Auditimit nr. 13/1, datë 07.01.2019 për veprimtarinë ekonomiko financiare të saj nga 01.9.2016 – 01.01.2019.

II. Të miratoj opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave dhe të procedohet me opinion e auditimit:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinionin (ISSAI 4000¹):

KLSH ka audituar veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Elbasan, në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe ISSAI 1700², dhe ISSAI 4000³.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë dhe atij financiar të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga DRM Elbasan dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

DRM Elbasan është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale. Ne kemi audituar pasqyrat financiare të DRM Elbasan për vitin ushtrimor, më 31 Dhjetor 2018, që përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar, hyrjeve dhe daljeve në para, pasqyra e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve dhe shënimet shpjeguese.

Nga auditimi financiar në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

Njësia shpenzuese DRM Elbasan organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit e ka realizuar nëpërmjet regjistrimit të veprimeve (në mënyrë manuale e excel) nga jashtë në mënyrë ekstra kontabile të faturave të blerjes, ndërsa janë hapur libra në excel për rregjistrimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre të ndara në kapituj, tituj e nën/tituj në ditarët analitik apo centralizator.

¹ **ISSAI 4000** – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

² **ISSAI 1700**- Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

³ **ISSAI 4000** – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

-Nga verifikimi për rregullshmërinë dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, shumat e llogarive të aktivitetit të pasivitetit në përgjithësi përputhen me shumat e anekseve të pasqyrave financiare, ndërsa llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike për gjendjet e llogarive në fund të vitit.

-Llogaritë që evidentohen në aktiv dhe pasiv të pasqyrës financiare gjendje në përfundim të periudhës raportuese janë hedhur në pozicionet e duhura, ndërsa nga krahasimi gjendjes së llogarive të periudhës së mëparshme me ato të paraqitura në mbyllje të pasqyrës financiare të periudhave raportuese objekt auditimi 2016; 2017 gjendjet rezultojnë:

-Për periudhën ushtrimore 2016- Zyra e financës në përfundim të periudhës raportuese me shkresë nr. 269 port, datë 28.02.2017 ka paraqitur me konfirmim nga dega e thesarit Elbasan përgatitjen e raportimit të pasqyrave financiare vjetore njësisë shpenzuese me anekset përkatëse brenda afatit të caktuar ligjor.

-Për periudhën ushtrimore 2017- Zyra e financës në përfundim të periudhës raportuese me shkresë nr. 113 prot, datë 27.02.2018 ka paraqitur me konfirmim nga dega e thesarit Elbasan përgatitjen e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë shpenzuese DRM me anekset përkatëse brenda afatit të caktuar ligjor.

-Për periudhën ushtrimore deri 31.12.2018; Përgatitja e raportimit pasqyrave financiare vjetore i njësisë shpenzuese DRM Elbasan me anekset përkatëse për periudhë raportuese 2018 bëhet brenda afatit ligjor deri në datën 28.02.2019, periudhë e cila është jashtë periudhës objekt auditimi, për të cilën kërkohet të përfundoj brenda afatit ligjor.

Opinion për pasqyrat financiare:

Për sa më sipër grupi i auditimit në mbështetje të evidencave të mjaftueshme dhe të besueshme, si dhe bazuar në standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe manualin e auditimit financiar japin opinion të pakualifikuar⁴:

Në gjykimin tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë mbi aspektet materiale (pa devijime të përhapura) dhe fluksin e parasë për vitin respektiv në përputhje me Kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik, si dhe të buxhetit të realizuar nga DRM Elbasan për vitin 2018, në përputhje me bazën ligjore.

Bazat për dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e aktivitetit të DRM Elbasan sipas kuadrit ligjor në fuqi:

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e aktivitetit rezultoi në mënyrë të përmbledhur se:

a-DRM Elbasan (që vepron në katër rrethet: Elbasan, Gramsh, Librazhd dhe Peqin dhe në 7 bashki: Elbasan, Belsh, Cërrrik, Gramsh, Librazhd, Peqin dhe Prrerjas) në formulimin e akteve të pranimit/refuzimit të lejeve të tipit (C) i mungojnë citimet në nenin apo pikën e bazës ligjore e nënligjore dhe pikat e shtojcës përkatëse për secilin prej kushteve të pa plotësuar, duke u mjaftuar vetëm me përmendjen apo citimin e ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për lejet e mjedisit”, si dhe mungojnë aktverifikimet në terren dhe relacionet përkatëse të grupit të specialistëve për argumentimin e tyre;

b- DRM Elbasan, për periudhën e auditimit 01.9.2016-31.12.2018, të shpërndarë në tre periudhat vjetore ka një numër total mos-vetdeklarimesh prej 483 subjektsh të shpërndara në periudhat si më

⁴Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, kapitulli IV, *Një opinion i pakualifikuar (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:*

(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;

(b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;

(c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe

(d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare

poshtë: janë 21 subjekte që nuk kanë sjellë vetë-monitorimin për periudhën 1 shtator-31 dhjetor 2016; 171 subjekte nuk kanë sjellë vetë-monitorimin gjatë vitit 2017; 291 subjekte nuk kanë sjellë vetë monitorimin për periudhën 1.01.2018-31.12. 2018, në kundërshtim me nenin 29, pika b (ii) të ligjit nr.10488, datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit”. Për mosplotësim të kushteve të lejes dhe numrit të vetë monitorimeve, duhej të aplikohesh penalitet me gjobë në masën nga 300 mijë lekë deri 500 mijë lekë. Nëse marrim parasysh kufirin minimal të gjobës prej 300 mijë lekë, të ardhurat e munguara për buxhetin e shtetit nga mungesa e vetdeklarimeve duhet të përlogariten në vlerën prej 144,900 mijë lekë (300 mijë x 483=144,900 mijë lekë);

c- DRM Elbasan nuk kishte formatin standard të Akt Refuzimit për Leje Tipi C ku të përfshihej saktësisht numri dhe data e aktit, të përfshihej, përcaktohej e cilësohej data e refuzimit të mëparshëm si dhe data e riaplikimit, me synim bërjen më transparente të shërbimit, respektimin e afateve, mospengimin dhe nxitjen e biznesit në pajisjen me lejet mjedisore Tipi C etj. në zbatim të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për Lejet e Mjedisit Kreu IV, pika 9. Në Akt-refuzim” nuk përshkruhen rastet e riaplikimit dhe nuk përcaktohen datat dhe sasia e refuzimeve (për herë të dytë data, për herë të treta, data) duke përshkruar shkurtimisht numrin e kushteve të paplotësuara), masë që do të rriste transparencën e DRM, do të lehtësonte biznesin dhe mbi të gjitha do të rriste shkallën e menaxhimit të subjektit;

d- DRM Elbasan për periudhën e auditimit 01.10.2016-01.10.2018, ka dhënë 182 dhënie mendimesi miratim për Leje mjedisi tip A/B dhe për VNM (paraprake dhe të thelluar) nga të cilat janë gjithësej 59 miratime (10 për Leje tip A dhe 49 për Leje tip B) dhe 123 miratime për VNM (106 VNM paraprake dhe 17 VNM të thelluara) shifra këto që nëse i rreshtojmë sipas tre periudhave të auditimit ndahen kështu: për periudhën e katër muajve të fundit, shtator-dhjetor të vitit 2016, ka gjithësej 4 miratime për Leje mjedisi tip A/B (3 për Leje tip A dhe 1 për Leje tip B) dhe 8 mendime për VNM cka do të thotë se ka gjithësej për këtë periudhë të auditimit 12 miratime. Për vitin 2017 ka gjithësej 77 miratime nga të cilat janë 30 dhënie mendimi me miratim për Leje tip A/B (4 Leje tip A e 26 Leje tip B) dhe 47 dhënie mendim me miratim për VNM (41 VNM paraprake dhe 6 VNM të thelluara).

e- Në DRM Elbasan, subjektet që paraqesin raporte vetëmonitorimi nuk kanë saktësinë dhe besueshmërinë e analizave nga subjektet e akredituara, pasi mungojnë laboratorët shtetërorë me ndihmën e të cilëve do të mund të sigurohej informacioni paralel në raste të subjekteve me ndikim të thellë në mjedis, për të përcaktuar saktësinë e të dhënave nga laboratorët e akredituar sipas VKM nr. 1185, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit në mjedis”, vendim i cili ka nevojë për ndryshime dhe përshtatje me kushtet e reja, duke sjellë mangësi në besueshmërinë e raporteve të vetëmonitorimit;

f- DRM Elbasan nuk ka pasur një bashkëpunim në shkallën e cilësinë e duhur me ISHMPUT Elbasan dhe nuk ka hartuar program pune bashkëpunimi me të dhe as me institucione të tjera rajonale për evidentimin nga verifikimi në terren në teritorin e Prefekturës Elbasan se sa aktivitete të ndryshme biznesi ushtrojnë aktivitete të pa pajisur me leje tipi (C), nga mungesa e bashkëpunimit me struktura të tjera shtetërore, sidomos me ISHMP dhe si pasojë e mos paisjes me leje mjedisore që nuk kanë arkëtuar tarifat përkatëse duke krijuar të ardhura të munguara në buxheti shtetit si edhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së Mjedisit në qark duke mos kryer kontrole të përbashkëta me to mbi subjektet, për të ushtruar kontrole monitorimi për informalitetin e zbatimit të kushteve për leje mjedisore në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe VKM nr. 47, datë 29.01.2014 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit”, Kreu V, germa (a), pika (1/n), Kreu VI, germa (a); -

g- DRM Elbasan në dokumentacionin elektronik të dosjeve për dhënie mendime për VNM e leje mjedisore tipi B, në shumicën e rasteve nuk ka të hedhura praktikatat e procesit të konsultimeve me

publikun. Për 4 muajt shtator –31 dhjetor 2016 ka pasur 4 dëgjesa në total; për vitin 2017 ka pasur 19 dëgjesa në total; për vitin 2018 ka pasur 36 dëgjesa në total. Gjithësej, për të gjithë periudhën e auditimit ka pasur 59 dëgjesa për 182 miratimet e kësaj periudhe për dhënie mendimi për lejet mjedisore;

j- Në studimet për VNM për leje tipi (B) në relacionet e paraqitura nga grupet e specialistëve të DRM Elbasan, sipërfaqet e zëna me pyllëzime nga subjektet e biznesit nuk janë përcaktuar sipas projekteve dhe nuk është parashikuar detyrimi i tyre për ripyllëzimin e sipërfaqeve të fondit pyjor sipas zërave kadastrale ku zhvillohet aktiviteti i tyre si në pyje, pyje shkurre, kullota e konvertuar në raportet sipas pikave 1; 2; 5 të Urdhrit nr. 1937 të Ministrit, datë 21.10.2014 “Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar sipërfaqet kullimore që hiqen nga fondi pyjor dhe kullor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre”. DRM Elbasan nuk mbante të dhëna mbi këtë çështje.

i - Sipas numrit të vetë-raportimeve monitoruese që nuk kanë plotësuar kriterin, pra numrin e vetëmonitorimeve brenda 6 mujorit, në zbatim të nenit 29 pika b (iii) i Ligjit nr. 10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit”, për mosplotësimin e kushteve të lejes për plotësimin e vetëmonitorimeve duhej të aplikoheshin masa bazuar tek pika iii), neni 29 i ligjit nr.10448 “Për lejet e mjedisit”, në gjoha nga 300 mijë deri 500 mijë lekë. Nëse ISHMPUT do të kishte aplikuar gjobën minimale prej **300 mijë** lekë për **736** subjektet që nuk kanë realizuar detyrimin për vetëmonitorim, llogaritet se ka një mosarkëtim në buxhet në shumën **220 800 000 (736 x 300 mijë)** lekë për këto subjekte të cilat do të ishin aktive.

Opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit:

*Nga **auditimi i përputhshmërisë⁵ në DRM Elbasan**, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualët e Auditimit të Përputhshmërisë, në gjykimin tonë profesional, aktiviteti i DRM Elbasan, në përgjithësi është kryer në përputhje me kuadrin rregullator. Megjithatë, nga auditimi i përputhshmërisë, u konstatuan edhe disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përmendura më lart, për të cilën japim **opinion të pakualifikuar**.*

A- MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: Ka fonde të munguara për shpenzime bazë, pagesa për shpenzime udhëtimi për specialistët në territoret që kanë kompetencë për të ushtruar verifikimet e nevojshme për subjektet e pajisura me leje mjedisore; ka fonde të munguara për shpenzime fotokopjime të dokumentave evidentuese, të domosdoshme dhe si pjesë e procedurave për paisjen me leje mjedisore të tipi (C), si dhe për dhënie të mendimesh në VNM dhe në lejet e tipit (A) dhe (B) të subjekteve aplikuese. Nuk ka shkresa drejtuar institucioneve qendrore në zbatim të ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, KREU II, Neni 11, “Përgjegjshmëria menaxheriale”, pika 3. “Menaxherët e strukturave garantojnë funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që ata drejtojnë, si dhe i raportojnë nëpunësit autorizues përkatës për çdo dobësi të sistemit që duhet trajtuar”. (Trajtuar në faqen 13-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1-Rekomandim: DRM Elbasan të ndërmarrë masa, që në mënyrë shkresore t’i bëjë të ditur institucioneve qendrore pamjaftueshmërinë e fondeve të alokuara, sepse ka mungesa në investime kryesisht për automjete për lëvizjen e specialistëve, për kontrollin e subjekteve që pajisen me leje mjedisore në territorin e qarkut në juridiksion, shpenzime bazë, shpenzime udhëtimi për specialistët në territoret që kanë kompetencë për të ushtruar verifikimet e nevojshme për subjektet e pajisura me

⁵ Sipas *Manualit të Auditimit Përputhshmërisë* të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4, “Opinion i pakualifikuar”, Kur audituesi nuk ka raste mospërputhshesh materiale për të raportuar, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të pamodifikuar

leje mjedisore, shpenzime fotokopjime të dokumentave evidentuese, të domosdoshme dhe si pjesë e procedurave për paisjen me leje mjedisore të tipi (C), si dhe për dhënie të mendimet në VNM në lejet e tipit (A) dhe (B) të subjekteve aplikuese.

Në vazhdimësi

2 - Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli që ju bë dosjeve të personelit të DRM Elbasan rezultoi se dosjet origjinale të punonjësve administrohen nga AKM, ndërsa në DRM u gjetën dosjet e punonjësve me fotokopje të dokumentave përkatëse. Në dosjet e personelit në dy raste mungonte fletë inventari i dosjes, gjë që bie në kundërshtim me VKM nr.117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit”, Kreu i parë “Dosja e personelit”, Pika 1. “Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë dhe të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre”. Në dosjen teknike të nëpunësit duhet të përfshihen: *Lidhja nr 1. “Fletëinventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje. Në 2 dosje nuk administrohet fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit, formati i së cilës mund të jetë i ndryshueshëm, por janë mjaftuar me Curriculum Vitae, kjo bie në kundërshtim me aktin e cituar më sipër (Trajtuar në faqet 19-22 të Raportit të Auditimit).*

2.1 - Rekomandim: Drejtori i DRM Elbasan të marrë masat që të gjitha dosjet e personelit të plotësohen me dokumentacion origjinal, apo fotokopje të noterizuara, duke bërë inventarizim të tyre. Në dosje të administrohet fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit formati i së cilës mund të jetë i ndryshueshëm.

Menjëherë

3 - Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të realizuar “blerje me vlerë e vogël” rezultoi se në procedurën “blerje e vogël” me anë të sistemit elektronik apo shkresor mungojnë ftesa për ofertë me kërkesat kualifikuese të OEsi dhe specifikimet teknike për artikujt që do blihen. Njësia e Prokurimit e blerjeve me vlera të vogla në DRM Elbasan, nuk ka marrë masa për përllogaritjen e saktë të fondit limit bazuar në testimin e tregut, në përputhje me VKM nr 914 Neni 40 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël”. 4. “Në rastin kur procedura e prokurimit me vlerë të vogël zhvillohet në rrugë shkresore, anëtarët ekomisionit testojnë tregun dhe të dhënat pasqyrojnë në një procesverbal të mbajtur dhe të nënshkruar nga komisioni”. DRM Elbasan nuk ka marrë masa, që të hartojë regjistrin e parashikimit dhe realizimit të prokurimit publik, me përllogaritjen e vlerës limit të njoftimit të kontratës, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik në fuqi. Në praktikat e prokurimit mungon Formulari nr.3, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin Nr.2, datë 18.02.2008 të Agjencisë së Prokurimit Publik, “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, pika nr 7. “Ky udhëzim shoqërohet me formularët standarte për prokurimin me vlera të vogla”. (Trajtuar në faqet 23-27 të Raportit të Auditimit).

3.1-Rekomandim: Njësia e Prokurimit e blerjeve me vlera të vogla në DRM Elbasan, të marrë masa për përllogaritjen e saktë të fondit limit, në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve. Para fillimit të procedurës së konkurimit të administrohen në dosjen e prokurimit ftesa për ofertë me kërkesat kualifikuese të OE, si dhe specifikimet teknike për artikujt që do të blihen. DRM Elbasan të hartojë rregjistrin e parashikimit dhe realizimit të prokurimit publik, me përllogaritjen e vlerës limit të njoftimit të kontratës, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik në fuqi.

Në vazhdimësi

4 - Gjetje nga auditimi: Anëtarët e komisionit në zbatim të urdhrave të titullarit mbi procesin e inventarizimit fizik të vlerave të aktiveve dhe nxjerjes së rezultatit e rakordimit nuk kanë përpiluar deklarata në se kanë ose jo konflikt interesi me punonjësin me përgjegjësi materiale, ose që kanë në përdorim aktive, edhe në rastin kur anëtarë e komisionit të inventarizimit është drejtuesi i njësisë që inventarizohet, njëkohësisht dhe përgjegjës material, veprim në mospërputhje me ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”. Komisionet në fillim të veprimtarisë së procesit të inventarizimit, nuk kanë hartuar akt-rakordim për të përcaktuar cdo objekt që inventarizohet, numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit, veprim në mospërputhje me pika nr.83 e UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. Komisioni i inventarizimit fizik në përfundim të procesit nuk ka përgatitur raportin informues për të paraqitur tek titullari i njësisë shpenzuese, informacionin mbi gjendjen fizike të vlerave të aktiveve, pasurisë e aseteve dhe materialeve të institucionit përfshirë periudhën raportuese datë 31.12.2016, veprime në mospërputhje me pikën 85, gërma (c) dhe pika 86 e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” (*Trajtuar në faqen 24 të Raportit të Auditimit*).

4.1-Rekomandimi: Anëtarët e komisionit për kolaudimin e marrjes në dorëzim të mallrave, të përpilojnë deklaratat nëse kanë ose jo konflikt interesi me punonjësin me përgjegjësi materiale dhe të kryerjes së punëve e shërbimeve. Komisionet në fillim të veprimtarisë së procesit të inventarizimit, të hartojnë aktrakordim për të përcaktuar dhe fiksuar në çdo objekt që inventarizohet, numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes të fundit dhe në përfundim të procesit të përgatisin raportin informues për të paraqitur tek Titullari i njësisë shpenzuese, informacionin mbi gjendjen fizike të vlerave të aktiveve, pasurisë e aseteve dhe materialeve të institucionit përfshirë.

Në vazhdimësi

5- Gjetje nga auditimi: DRM Elbasan nuk ka të evidentuar listën e subjekteve që duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të tipit (C) prej vetmonitorimit bazuar tek *neni 29, pika 1, gërma b (iii) i ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe ligjit 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe nenit 22, pika 4 dhe neni 45/3, pika ‘i’ i ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, kapitulli V/1, nënpika II/n i VKM Nr. 47, datë 29.1.2014 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit”, të përditësuar nga bashkëpunimi periodik me ISHMPUT, DR Tatimeve Elbasan, QKL apo dhe me NJVQV^{-të} (5 bashki) për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në qarkun e Elbasanit e që kanë ndikim në mjedis, me detyrim pajisjen e tyre me leje mjedisi për ushtrimin e veprimtarive (*Trajtuar në faqen 47 të Raportit të Auditimit*).*

5.1-Rekomandim: DRM Elbasan në bashkëpunim me AKM Tiranë, të marrë masa për të evidentuar e ndjekur subjektet mbajtës të lejeve mjedisore tipi (C), duke rakorduar me DR Tatimeve Elbasan, QKL dhe NJVQV^{-të}, për përditësimin e listave me numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë në cdo periudhë të kohës veprimtari ekonomike në qarkun Elbasan.

Brenda muajit nëntor 2019

6 - Gjetje nga auditimi: DRM Elbasan në formulimin e akteve të refuzimit të Lejeve tipi (C), është konstatuar se ka raste kur mungojnë citimet në nenin apo pikën e bazës ligjore e nënligjore kryesisht të pikave a, b të nenit 21 të Ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “*Për lejet e mjedisit*” dhe pikat 1-9 të shtojcës përkatëse për secilin prej kushteve konkrete të paplotësuar, duke u mjaftuar vetëm me përmendjen apo citimin e ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “*Për lejet e mjedisit*”, si dhe mungojnë aktverifikimet në terren dhe relacionet përkatëse të grupit të specialistëve për argumentimin e tyre (*Trajtuar më hollësisht në faqe 37-47 të Raportit të Auditimit*).

6.1-Rekomandim: DRM Elbasan të marrë masa, që komisionet e shqyrtimit të dosjeve për aplikim të lejeve të përgatisin dhe formulojnë akt-refuzimet në mënyrë të plotë, duke i mbështetur shkaqet e refuzimit me bazën nënligjore të kushteve mjedisore sipas përcaktimeve përkatëse në pikat e shtojcave nga 1-9 të Ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe të japin argumenta teknike dhe të dokumentuara kur miratojnë Lejet tipi C, pasi i kanë refuzuar një herë apo dy herë më parë ato.

Në vazhdimësi

7 - Gjetje nga auditimi: Në DRM Elbasan u konstatua se procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve teknike janë mbajtur pa rregulla drejtshkrimi dhe pa korrektesë gjuhësore gjatë verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për miratimin ose refuzimin e lejeve mjedisore. U konstatuan mangësi në konceptim dhe formulim dhe nuk janë evidentuar saktësisht diskutimet, mendimi i NJQV, dokumentacioni, situatat, zhvillimi i tyre, duke mos prezantuar një informacion dhe panoramë të plotë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe nenit 3/c të VKM nr. 419, datë 25.06.2014. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 44-45 të Projekt Raportit të Auditimit).*

7.1-Rekomandim: DRM Elbasan, kryetari i komisionit dhe antarët e tij, të marrin masa që në procesverbalet e mbajtura në mbledhjet e komisioneve për leje mjedisi tipi (C), në çdo rast duhet të pasqyrohen e citohen saktësisht nga ana e formës së shënimeve dhe përmbajtjes gjithë aktiviteti gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në mbledhjet e komisioneve teknike dhe të pasqyrohen në këto procesverbale në mënyrë objektive dhe sipas rregullave të drejtshkrimit arsyet e pranimit/refuzimit, mangësitë ligjore dhe dispozitat përkatëse, duke kërkuar respektimin e kushteve apo kritereve ligjore që duhen plotësuar nga subjektet, me informacion të plotë për vlerësimin e dokumentacionit duke argumentuar gjithashtu si aktet e miratimit, ashtu edhe ato të refuzimit, me arsyet dhe argumentet përkatëse. Për këtë në procesverbalet e mbledhjeve të komisionit të pasqyrohet edhe zotërimi i dokumentave të pronësisë, dokumentimi i mendimit të NJVQV^{ve} dhe informacioni tjetër ligjor që lidhet me mbrojtjen e mjedisit.

Në vazhdimësi

8 - Gjetje nga auditimi: Në DRM Elbasan u konstatua se subjektet që paraqesin raportet e vetëmonitorimit, nuk kanë saktësinë dhe besueshmërinë e analizave, pasi mungojnë fonde dhe bashkëpunimi me laboratorë të çertifikuar me ndihmën e të cilave do të mund të sigurohej verifikimi dhe një informacion mbi saktësinë e raporteve sipas të dhënave teknike të laboratorëve të akredituar sipas VKM nr.1185, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit në mjedis”, vendim i cili ka nevojë për ndryshime dhe përshtatje me kushtet e reja, çka ka sjellë mangësi në raportet e vetëmonitorimit *(Trajtuar më hollësisht në faqet 54-62 të Raportit të Auditimit).*

9.1-Rekomandim: DRM Elbasan, në bashkëpunim me AKM Tiranë, të marrin masa që të parashikohen fondet e nevojshme që të lidhin kontrata me subjekte të licencuara dhe akredituara për marrjen e shërbimit të kërkuar për verifikimin, sa herë që ato e shohin të nevojshme, për kontrollin e të dhënave të raporteve të vetëmonitorimit që sjellin subjektet, për të pasur paralelisht analiza shoqëruese dhe verifikuese.

Në vazhdimësi

9 – Gjetje nga Auditimi: Mungesa e raporteve të vetëmonitorimit, sipas nenit 41 pika 1 e ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, për të gjitha kategoritë e lejeve bën që të mos njihet

siç duhet gjendja e mjedisit në qarkun Elbasan me të dhënat e shkarkimeve në tokë, ujë dhe ajër, si rezultat i mungesës së mbajtjes së një regjistri të përditësuar në bashkëpunim me informacionet që japin DRT Elbasan dhe QKB-ja mbi statusin e subjekteve që duhet të jenë të pajisura me Leje Mjedisore si parashikimeve të bëra në kërkesat e ligjit nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”.

Raportet e vetëmonitorimit nuk janë vlerësuar teknikisht për shkarkimet apo ndërhyrjet që kanë në mjedis, në varësi të aktivitetit/veprimtarisë që ushtrojnë subjektet e ndryshme me Leje Tipi C, referuar dispozitave ligjore të mjedisit, sidomos referuar nenit 41 pika 1 i ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 58-60 të Raportit të Auditimit*).

9.1-Rekomandim: DRM Elbasan të marrë masa për përditësimin e një database të veçantë, me numrin e subjekteve dhe numrin e raporteve të vetëmonitorimeve periodike që duhet të paraqiten nga secili subjekt aktiv, numrin e raporteve të vetëmonitorimit të dorëzuara dhe ato që duhet të dorëzohen, me afate dhe data përkatëse, në varësi të llojit të veprimtarisë së subjektit dhe kushteve të lejes.

Në vazhdimësi

10 - Gjetje nga Auditimi: DRM Elbasan për periudhën raportuese tetor 2016 – tetor 2018, ka dhënë **123 pëlqime me vlerësime të ndikimit në mjedis (VNM)** dhe **59 pëlqime** për leje mjedisore për licencimet të tipit (A), (B) nga AKM. Për këto DRM Elbasan nuk ka informacione nga AKM Tiranë për ecurinë e procedurës për **shumicën e praktikave të dhënies së mendimit**. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 10 të ligjit Nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” të ndryshuar dhe urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr.1964, datë 13.11.2014 “Për miratimin e procedurave të administrimit dhe formatit të regjistrave të lejeve të mjedisit të tipit (A), (B) dhe (C)”. Të dhënat sipas tabelës të treguar në Raport ku jepen të dhënat me pëlqimet për VNM dhe leje mjedisore tipi (A-B) për periudhën shtator 2016 – 31 dhjetor 2018 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 50-54 të Raportit të Auditimit*)

10.1-Rekomandim: DRM Elbasan të kërkojë zyrtarisht nga AKM Tiranë, marrjen e të dhënave në lidhje me ecurinë e praktikave të dhënies së mendimeve për VNM^{-të} e Lejet mjedisore tipi (A; B), me synim përditësimin në formë elektronike të regjistrit të lejeve tipi (A,B), sipas formatit standard të miratuar, zbatimin e afateve dhe procedurave ligjore, si dhe mundësimin e bashkëpunimit ligjor me strukturat e tjera si, DRISHMU, NJVQV^{-të} dhe QKL.

Menjëherë

11- Gjetje nga auditimi: DRM Elbasan për periudhën raportuese 01 shtator 2016 – 31 shjetor 2018, nuk ka program pune për bashkëpunim dhe kryerje të kontrolleve permanente të përbashkëta dhe bashkëpunim me NJQV (*bashki e njësi administrative*) për mbetjet urbane dhe mbetjet spitalore sipas Urdhërit Nr. 16, datë 06.11.2017 “Për ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e programit për evidentimin e problematikës mjedisore në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, bashkëpunimi ndërmjet DRM dhe ISHMPU Elbasan ka qenë sporadik, i planifikuar nga MTM, në kushtet e pamjaftueshmërisë dhe eficientës. Ky bashkëpunim nuk është i shtrirë në të gjithë intervalin kohor të periudhës së auditimit në zbatim të kushteve të lejeve mjedisore, në përmbushje të kërkesave të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe kërkesave të përcaktuara në Kreu 5, germa pika (1/n), Kreu VI, germa (a), VKM nr. 47, datë 29.01.2014 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 53-54 të Raportit të Auditimit*).

11.1- Rekomandimi: DRM Elbasan, në bashkëpunim me AKM, të ndikojë që të merren masa për hartimin e programit vjetor punës, në të cilin të pasqyrohen qartë edhe bashkëpunimet me

institucione të tjera rajonale, me qëllim kryerjen e monitorimeve nëpërmjet kontrolleve të përbashkëta, në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet DRM Elbasan me organet e tjera lokale të kontrollit, si me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Elbasan, ISHMPUT Elbasan dhe Nj.Q.V për informalitetin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore dhe ndikimit në mjedis.

Në vazhdimësi

12 - Gjetje nga auditimi: DRM Elbasan për periudhën raportuese 01 shtator 2016 – 31 dhjetor 2018, në shqyrtimin e procedurave të pëlqimit mjedisor dhe miratimit të lejeve mjedisore tipi (C) ka shqyrtuar gjithësej **525** raste duke kërkuar mendim nga NJQV në **447** raste (nga të cilat në **123** raste nuk ka përgjigje), ka dhënë pëlqim mjedisor në të gjitha rastet e shqyrtuara (në **182** raste) dhe ka miratuar **343** lejet Tip C pa marrë në **201** raste në total përgjigje nga NJQV^{-të}. DRME ka vepruar në këtë rast në heshtje sipas të drejtës që i jep Kreu IV, VKM nr. 419, datë 25.06.2014, pika 2 dhe 3, ku citohet se: “... brenda 3 ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit, DRM dërgon një kopje të aplikimit në NJQV e cila jep mendimin e saj me shkrim brenda 3(tre) ditë pune...”.(Trajtuar më hollësisht në faqen 35-36 të Raportit të Auditimit).

12.1- Rekomandimi: DRM Elbasan të marrë masa dhe të gjejë forma bashkëpunimi për miratimin e lejeve të subjekteve nga ana e NJQV^{-të} përkatëse, të komunikojë e sigurojë dhënien e mendimit nga ana e saj me shkrim brenda 3(tre) ditëve. Në mungesë të bashkëpunimit të plotë të dhënies së mendimit nga NJQV^{-të} brenda afatit 3 (tre) ditor, DRM Elbasan herë pas here për rastet e mosdhënies së mendimit të njoftojë zyrtarisht AKM Tiranë dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Në vazhdimësi

13 - Gjetje nga Auditimi: DRM Elbasan në dokumentacionin elektronik të dosjeve për dhënie mendimi për VNM^{-të} dhe për pëlqim mjedisor për Leje mjedisore të tipit A e B,ku për të gjithë periudhën e auditimit 01 shtator 2016 – 31 dhjetor 2018 ka pasur gjithësej **197** raste në total të shqyrtuara, vetëm në **60** raste ka pasur konsultim me publikun, për shkak se për kaç raste kishte kërkuar AKM ndaj DRM Elbasan të bëheshin dëgjesa. Në **137** raste për dëgjesat me publikun DRME shprehet se; “...do të kryhen hap pas hapi në fazën e zbatimit të projektit...”. Nga auditimi u konstatua se në subjektet që kanë filluar punimet, deri në përfundim të periudhës së auditimit, nuk ka informacione për realizimin e të gjitha këtyre dëgjesave, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore të Tipit A,B,C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL”, Kreu I, pika 1/dh, Kreu VI, pika 12; 13; 15; 16 dhe 22 (Trajtuar më hollësisht në faqet 51-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1- Rekomandim: DRM Elbasan në bashkëpunim me AKM Tiranë, të marrë masa që të plotësojnë praktikën e dhënies së mendimeve për të gjitha rastet për periudhën e auditimit, si dhe të dërgohen në NJQV^{-të} përkatëse regjistri i përditësuar i të dhënave për VNM^{-të} e lejes mjedisore. Gjithashtu DRM Elbasan dhe AKM të bashkëpunojnë dhe të marrin masa për rregullimin e normimit juridik të pikës 6, “Mendimi i DRM pas inspektimit në terren”, të formatit dhënie mendim për VNM dhe LM, me synim bërjen e tij funksional dhe sigurimin e vërtetësisë për përfshirjen e mendimit të NJQV në VNM dhe në lejet e tipit B, jo thjesht si një akt formal.

Në vazhdimësi

B- TË ARDHURA TË MUNGUARA

1 - Gjetje nga auditimi: Për periudhën raportuese objekt auditimi DRM Elbasan ka pajisur dhe miratuar leje mjedisore të tipit (C) gjithsej **269** subjekte; nga të cilat kanë kryer pagesat e tarifave **244** subjekte në vlerë **408** mijë lekë, ndërsa nuk kanë arkëtuar dhe janë debitorë **25** subjekte. Kjo vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit, si pasojë e mos arkëtimit të tarifës së Lejes tipi (C) është në mospërputhje me nenin 3/c dhe nenin 5 të VKM nr.417, datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”. Si pasojë e mos pagesës së tarifës së Lejes mjedisore tipi (C), nga subjektet e paisjitur me leje mjedisore për periudhën raportuese objekt auditimi, apo edhe për periudhën nga krijimi institucionit të DRM-së me detyrime të mbartuara, si edhe nga procesi i pezullimit të lejeve mjedisore për subjektet me status të pezulluar dhe me QKB për periudhën 01.09.2016, 2017, 2018, institucioni ka krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën **852 mijë lekë** (628 mijë lekë+224 mijë lekë të prapambetura) *(Trajtuar në faqen 16-19 të Raportit të Auditimit)*.

1.1-Rekomandim: DRM Elbasan të marrë masa për saktësimin e adresave dhe të njoftojë të **25** subjektet me leje Mjedisore tipi (C), të cilët nuk kanë bërë pagesën e tarifës vjetore në vlerën **852 mijë lekë** sipas kërkesave ligjore të përcaktuara dhe në kushtet e lejeve të Mjedisit. DRM Qarku Elbasan të marrë masa që subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë qark dhe që janë të pajisur me Leje Mjedisit të Tipit (A, B dhe C) të paguajnë tarifën vjetore brenda 3 mujorit të II^{të} të vitit ushtrimor.

Deri nw muajin dhjetor 2019

2 - Sipas numrit të vetë-raportimeve monitoruese që nuk kanë plotësuar kriterin, pra numrin e vetëmonitorimeve brenda 6 mujorit, në zbatim të nenit 29 pika b (iii) i Ligjit nr. 10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit”, për mosplotësimin e kushteve të lejes për plotësimin e vetëmonitorimeve duhej të aplikoheshin masa bazuar tek pika iii), neni 29 i ligjit nr.10448 ”Për lejet e mjedisit”, në gjoba nga 300 mijë deri 500 mije lekë. Nëse ISHMPUT do të kishte aplikuar gjobën minimale prej **300 mijë lekë** për **736** subjektet që nuk kanë realizuar detyrimin për vetëmonitorim, llogaritet se ka një mosarkëtim në buxhet në shumën **220,800,000 (736 x 300 mijë)** lekë për këto subjekte të cilat do të ishin aktive. *(Trajtuar në faqen 66-69 të Raportit të Auditimit)*.

2.1- Rekomandim: DRM Elbasan, të verifikojë statusin e **736** subjekteve mbi të cilat nuk është aplikuar gjoba minimale në shumën **220,800,000** për moskryerjen e raportimit e vetëmonitorimit për periudhën e auditimit dhe të ndjekë në bashkëpunim me AKM dhe ISHMPUT Elbasan të gjitha procedurat ligjore për kryerjen e raportimit e vetëmonitorimeve.

Brenda marsit 2020

B. MASA DISIPLINORE

E.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr.115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmartjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", në ligjin nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, në ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM nr.47, datë 29.01.2014 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë

Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit”, i rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm të AKM Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës me status nëpunësi civil fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” për këta punonjës:

1. Për z. *E. Xh*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM) e leje mjedisi, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në Akt-Konstatimi numër 2, datë 15.03.2019;
2. Për z. *L. I*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM) e leje mjedisi, për shkeljet e trajtuara në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në Akt-Konstatimi numër 2, datë 15.03.2019;
3. Për z. *A. M*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM) e leje mjedisi, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në Akt-Konstatimi numër 2, datë 15.03.2019;
4. Për z. *F. M*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM) e leje mjedisi, për shkeljet e trajtuara në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në Akt-Konstatimi numër 2, datë 15.03.2019;
5. Për z. *L. I* me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM) e leje mjedisi, për shkeljet e trajtuara në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në Akt-Konstatimi numër 2, datë 15.03.2019;
6. Për z. *F. P*, me detyrë specialist monitorues, për shkeljet e trajtuara në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në Akt-Konstatimi numër 3, datë 15.03.2019

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit